

FJALA E DEPUTETES OLTA XHAÇKA

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar kolegë,

Gjatë javëve të fundit, kam pasur mundësinë të diskutoj për buxhetin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme me kolegët e Komisionit të Jashtëm dhe ata të Komisionit të Integritetit, të cilët gjej rastin t'i falënderoj për diskutimet dhe sugjerimet e tyre. Është edhe falë këtij angazhimi, jam e bindur se buxheti për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme për vitin 2022 është produkti më i mirë i mundshëm, që na mundëson të përmbushim me dinjitet e profesionalizëm objektivat që i kemi vënë vetes për vitin që vjen. Them më i miri i mundshëm, pasi sigurisht që në një botë ideale secili nga ne do të preferonte që në fund të çdo viti t'i dorëzohej një çek i bardhë për dikasterin që përfaqëson, çka sigurisht nuk ka ndodhur e nuk mund të ndodhë. Ama, ajo që mund të them me gojën plot, është që projektbuxheti që votojmë sot është pa dyshim tregues i faktit që kërkesat tona janë trajtuar me seriozitet maksimal, gjë që na lejon të përmbushim qëllimet strategjike madhore të politikës sonë të jashtme. E them këtë, sepse, krahasuar me buxhetin e këtij viti, projektbuxheti i vitit 2022 ka një rritje prej 17 %, çka pa dyshim na shton mundësitë për të përmbushur më mirë aktivitetin tonë diplomatik dhe posteve konsullore jashtë vendit, për të përmbushur të gjitha objektivat dhe prioritetet tona strategjike, e, për më tepër, për të shfrytëzuar në mënyrë më optimale momentin dhe mundësitë e paprecedenta që paraqiten sot për diplomacinë shqiptare. Viti 2022 është vërtet një vit i paprecedentë për diplomacinë tonë, sepse është një vit që shënon kulmimin e një pune të gjatë e të suksesshme për të ringritur diplomacinë shqiptare.

Për herë të parë Shqipëria është duke investuar për një diplomaci me një dimension realisht global, që e zgjeron shumë hapësirën e veprimit të shërbimit tonë të jashtëm. Në këtë dritë duhet parë edhe ky projektbuxhet, i cili ndërton dhe çon përpara punën e bërë në këtë ministri në vitet e mëparshme, frytet e të cilave jemi duke korrur sot. Dhe janë disa prioritete të mëdha, të cilat në 2022-shin kanë momentet e tyre kulmore. Së pari, progresi drejt negociatave të anëtarësimit, që kanë qenë prioriteti më i rëndësishëm i politikës së jashtme për vitin 2021. Sot jemi më pranë se kurrë këtij objektiv, duke arritur në situatën ku jemi sot, ku progresi i vendit dhe përmbushja e kushteve njihet qoftë nga Komisioni, qoftë nga vendet anëtare, por procesi është bllokuar për shkak të një situatë bilaterale mes Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, duke sjellë këtë situatë anormale ku jemi sot. Së dyti, mandati dyvjeçar në Këshillin e Sigurimit, pas 65 vjetësh anëtarësim në Kombet e Bashkuara, besoj është prova më e pakundërshtueshme e respektit që gëzon sot politika e jashtme e Shqipërisë, po ashtu prova e asaj që mund të arrijmë ne si vend, kur jemi të qartë, kur jemi konkretë dhe kur punojmë sipas planeve të konsoliduara shumëvjeçare.

Së treti, konsolidimi i rolit dhe peshës së Shqipërisë në rajon, i cili sot më shumë se kurrë ka një rëndësi vendimtare. Fakti që sot diplomacia jonë ka një horizont mjaft më të gjerë, që sheh përtej rajonit, natyrisht nuk ka prodhuar një situatë vetëkënaqësie dhe nuk na ka bërë të heqim për asnjë moment vëmendjen nga rajoni, siguria e stabiliteti i të cilit, siç e kanë treguar edhe momentet e tensionit në Veri të Kosovës, situata në Bosnje-Hercegovinë apo edhe situata mes Maqedonisë së Veriut e Bullgarisë, pavarësisht se është stabël dhe në rrugën e duhur për momentin, vazhdon të mbetet e brishtë. Pikërisht pse rajoni sot ndodhet në një pozitë kaq delikate, roli i Shqipërisë bëhet më vendimtar se kurrë, dhe pesha jonë strategjike më e madhe se kurrë. Fokusi kryesor i punës sonë në rajon ka qenë dhe mbetet pa dyshim mbështetja dhe faktorizimi i shqiptarëve në mbarë hapësirën e

Ballkanit Perëndimor. Siç jeni në dijëni, pas një sërë vizitash të nivelit të lartë me Kosovën, ne jemi tashmë duke përgatitur mbledhjen e shtatë të përbashkët të dy qeverive, me një agjendë ambicioze e konkrete, duke finalizuar një numër marrëveshjesh e duke vënë në lëvizje një sërë procesesh, që do të intensifikojnë bashkëpunimin mes nesh, ku një vend të rëndësishëm zë bashkimi i forcave për financimin e projekteve të zhvillimit në mbështetje të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Krahas forcimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet e rajonit, ku do të veçoja intensifikimin e agjendës dypalëshe me Turqinë apo thellimin e dialogut politik intensiv me Italinë, ku së shpejti do të ketë edhe një vizitë zyrtare të Kryeministrit, apo përgatitjet për mbledhjen e dytë të përbashkët të qeverisë me Maqedoninë e Veriut dhe punën për mbledhje të përbashkëta trepalëshe me vende të tjera të rajonit, si Kroaci-Mali i Zi, Kroaci-Kosovë. Zhvillimi më i rëndësishëm që është shënuar në fushën e bashkëpunimit rajonal, është në kuadër të Procesit të Berlinit, ku Shqipëria u bë një nga vendet nismëtare të nismës Ballkani i Hapur, që synon të përshpejtuar këtë proces, procesin e Berlinit, dhe të realizojë në rajon sa më parë katër liritë themelore të Bashkimit Europian. Tanimë kjo nismë ka filluar të konkretizohet me marrëveshjet e para, ndërkohë që ka marrë edhe mbështetjen qoftë të Bashkimit Europian, qoftë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, çka është padyshim një garanci më tepër që jemi duke bërë gjënë e duhur dhe se kjo është një ide e mirë për të përshpejtuar integrimin e rajonit tonë. Por krahas diplomacisë, një tjetër dimension i rëndësishëm i punës sonë është ofrimi i shërbimeve për qytetarët shqiptarë jashtë vendit, dhe në këtë drejtim është bërë një punë e konsiderueshme qoftë për sa i përket shërbimeve konsullore, ku po vazhdon puna për dixhitalizimin e plotë të tyre, qoftë për sa i përket diasporës, ku kemi arritur të krijojmë një rrjet horizontal konsultimi me shoqatat e diasporës, por mund të them se kjo punë do të intensifikohet gjatë vitit 2022, kur kjo fushë përgjegjësie do të kalojë plotësisht nën varësinë e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, bashkë me strukturën dhe buxhetin përkatës. Pra, projektbuxheti i vitit 2022 do të ndërtojë mbi këto arritje. Më konkretisht puna do të fokusohet në disa objektiva:

Në nisjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian, çka në terma konkretë do të thotë zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe të përfaqësive diplomatike, për procesin e negociatave të anëtarësimit në BE, por edhe zhvillimin e një fushate lobimi e komunikimi me të gjitha shtetet anëtare për të mbështetur avancimin e Shqipërisë në këtë proces. Më tutje projektbuxheti për vitin 2022 do të na lejojë të realizojmë prioritetet të rëndësishme: -Zhvillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. -Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimAsociimit. -Mirëmenaxhimin e asistencës së fondeve të Bashkimit Europian në mbështetje të procesit të anëtarësimit. - Forcimin e kapaciteteve institucionale në funksion të procesit të negociatave të anëtarësimit dhe menaxhimit të asistencës financiare. - Zhvillimin me sukses të mandatit tonë në Këshillin e Sigurimit, që përfaqëson një sfidë madhore, një sfidë të jashtëzakonshme, por edhe një mundësi të shkëlqyer, që ndoshta do të duhen dekada që të na jepet prapë. Në këtë kontekst, objektivi ynë është shfrytëzimi sa më i mirë, në shërbim të vendit, i kësaj mundësie, duke lënë gjurmë pozitive dhe duke e rritur reputacionin e vendit, por, edhe duke shënuar arritje e rezultate konkrete, siç janë shtrirja e njohjeve dhe bashkëpunimit në rajone apo organizata ndërkombëtare, ku deri më sot kemi qenë fare pak ose aspak të pranishëm, lobimi për interesa kombëtare, ku pa dyshim prioritet është Kosova, apo interesa shtetërore, siç janë lidhja e marrëveshjeve apo krijimi i lidhjeve tregtare e diplomatike. Për këtë qeveria na ka alokuar fondet e posaçme shtesë në buxhetin për vitin 2022, duke filluar përmes një planifikimi, që në fakt nisi që vjet deri në vitin 2023, me anë të të cilave është bërë i mundur shtimi i kapaciteteve njerëzore në misionin tonë në Nju Jork, ku janë katërfishuar kapacitetet njerëzore.

Sigurisht, me ambiente të reja të pune, me trajtim financiar për diplomatët dhe familjet e tyre, me akomodim në kushte të përshtatshme dhe me më shumë fonde për ushtrimin e aktivitetit diplomatik. Më tutje do të punojmë për forcimin e marrëdhënieve me vendet e rajonit, ku puna do të ecë në disa

drejtimet: - Marrëdhëniet vëllazërore me Kosovën. E përmenda më lart mbledhjen e përbashkët, por një angazhim të veçantë do të ketë për të konkretizuar marrëveshjet e arritura gjatë mbledhjeve të përbashkëta të qeverive të mëparshme, ndërkohë që Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë praninë dhe aktivitetin e Kosovës në organizatat rajonale e ndërkombëtare dhe po bashkërendohet puna për të blerë edhe disa ambasada të përbashkëta, për të pasur shkëmbim të diplomatëve në ambasada dhe në ministri, si dhe ngritje të grupeve të përbashkëta të punës për të vendosur pastaj edhe modalitetet, edhe angazhimet financiare. Po ashtu, edhe marrëdhëniet me Italinë, me Greqinë, me Turqinë, me Maqedoninë e Veriut, si dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partneri ynë strategjik, për një prezencë dhe vëmendje për rajonin. Po e mbyll fjalën time, duke ju thënë se viti 2022 do të jetë një vit plot sfida, do të testojë shumë aftësitë dhe profesionalizmin e shërbimit tonë të jashtëm, por do të jetë edhe një vit, i cili do të mbahet mend gjatë në diplomacinë shqiptare si viti kur politika jonë e jashtme bëri kapërcimin e madh nga një diplomaci e suksesshme rajonale në një diplomaci me një diapazon shumë më të gjerë, pse jo edhe global. Projektbuxheti që po diskutojmë sot na krijon çdo mundësi për t'u përballur siç duhet me këto sfida dhe për të përmbushur me sukses objektivat tona, prandaj ju ftoj që të votojmë së bashku. Faleminderit!